

**UDHËZIM**  
**Nr. 26, datë 27.12.2012**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 16.3.2010 “PËR MARRJEN E MASAVE TË SIGURISË SË TË DHËNAVE PERSONALE NË VEPRIMTARINË E FUSHËS SË ARSIMIT”**

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 dhe të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me ligjin nr. 48/2012,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 4, datë 16.3.2010 “Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijojnë:

1. Pas titullit të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, shtohen fjalët si vijojnë:  
“i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012.”

2. Pas pikës 10 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

10/1. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendimin nr. 3, datë 19.11.2012 të komisionerit. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale mund të bëhet në rastet e parashikuara në pikën 2 të nenit 8 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me ligjin nr. 48/2012 ose me autorizim të komisionerit sipas nenit 9, të ligjit të sipërpërmendur.

3. Fjalja e dytë e pikës 12, ndryshohet si vijon:

“Pëlqimi i subjekteve të të dhënave është deklarata me shkrim, e shfaqur me vullnet të qartë, të plotë e të lirë, çka nënkupton që subjekti i të dhënave është informuar për arsyen e përpunimit dhe pranon që të dhënat e tij të përpunohen.”

4. Pas pikës 14 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

“15. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.”

Ky udhëzim hy në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONERE**  
**Flora Çabej (Pogaçe)**